



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
MAT**

RAPORT – VJETOR

Lidhur me treguesit e punës dhe veprimtarisë së Prokurorisë së Rrethit Gjiqësor Mat për vitin 2016, dhe prioritetet për vitin 2017.

Prokuroria e Rrethit Gjiqësor Mat, analizon në këtë raport veprimtarinë e punës të periudhës 1-vjeçare për vitin 2016, gjendjen e kriminalitetit në territorin ku ushtrohet veprimtaria ligjore, pra në juridiksionin që ushtron veprimtarinë e saj, përmbushjen e detyrimeve ligjore si institucion dhe Prokurorëve që përfaqësojnë atë, arrijtjet problemet dhe mangësitë e evidentuara, si dhe përcaktimin e prioriteteve dhe drejtimeve kryesore për përsosjen e mëtejshme të veprimtarisë së saj në të ardhmen.

Gjatë vitit 2016, Prokuroria e Rrethit Gjiqësor Mat e ka ushtruar veprimtarinë e saj në mbështetje dhe respektim të plotë të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, si dhe ato që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare dypalëshe dhe shumëpalëshe, të ratifikuara me ligj nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ushtrimi i kësaj veprimtarie kushtetuese dhe ligjore, ashtu siç edhe do të analizohet në vijim të këtij raporti, është kryer, bazuar në një angazhim maksimal të të gjithë stafit të kësaj prokurorie, duke ndjekur dhe respektuar me përpikmëri edhe çdo urdhër dhe udhëzim të Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë.

Prokuroria e Rrethit Gjiqësor Mat, ushtron veprimtarinë e saj të ndjekjes Penale, në juridiksionin e rrethit Mat.

Prokurorët dhe Of/Pol/Gjiqësore të Prokurorisë së Rrethit Gjiqësor Mat, duke shtuar këtu dhe trupën e shërbimeve të Policisë Gjiqësore pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Diber, gjatë kësaj periudhe që analizojmë rezultojnë se i janë përkushtuar punës, duke ju përmbajtur respektimit të ligjit si detyrim parësor,

krijuar kushtet dhe rrethanat ligjore të zbatimit të të drejtave të njeriut, për arritjen dhe vënien para përgjegjësive penale të autorëve të kryerjes së veprave Penale, por dhe duke zbatuar dhe respektuar të drejtat procedurale ndaj tyre gjatë procesit hetimor.

Gjatë vitit 2016, për përballimin e punës dhe ushtrimin e veprimtarisë Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat ka patur në përbërje të organikës së saj 3-Prokurorë, përfshirë drejtuesin (deri në fillim të muajit mars ka qenë dhe Prok.L.Filopati dhe deri në muajin qershor ka qenë dhe Prok.A.Prençi), 2-oficerë të policisë gjyqësore, si dhe 4-punonjës të administratës. Po kështu, për ushtrimin efikas të veprimtarisë së kësaj Prokurorie, një ndihmë dhe bashkëpunim të rëndësishëm kanë dhënë edhe oficerët e policisë gjyqësore të Seksioneve të Policisë pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Diber, si dhe oficerët e policisë gjyqësore pranë Komisariateve të Policisë Mat dhe Diber, të cilët kanë mbajtur edhe një peshë të konsiderueshme në hetimin e çështjeve penale të rregjistruara gjatë këtij viti.

Rezulton se gjatë kësaj periudhe 1-vjeçare, nga ana e prokurorëve të kësaj prokurorie është ushtruar ndjekja penale dhe janë ndjekur procese gjyqësore në një numër të konsiderueshëm çështjesh penale, të rregjistruara për një larmi të ndryshme veprash penale.

Gjatë kësaj periudhe është kryer një volum i konsiderueshëm pune, në krahasim me një vit më parë në 2015-ën, si të regjistrimeve të çështjeve penale, por dhe një numër i ndjeshëm i akteve të referuara për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal konkretisht për 168 - mosfillime, nga këta në 15 raste është ushtruar ankim në Gjykatën e Shkallës së Parë, dhe ka lene në fuqi vendimet e mosfillimit në 15 raste dhe një rast ankimuar në Prokurori dhe është lene në fuqi. Ka një rritje përsa i përket përfaqësimit në gjykim në lidhje me kërkesat për “lirim me kusht” neni 64 K.Penale dhe “dënimet alternative” neni 59/a i K.Penale, nga 30-përfaqësime në 35 –përfaqësime.

Mendoj se më qartë veprimtaria e Prokurorisë do të rezultonte duke analizuar treguesit sipas dinamikës së vendimarrjes referuar dhe praktikës procedurale që ndiqet, nga momenti i konstatimit të veprave penale nëpërmjet vend-ngjarjeve, kallëzimeve penale etj, që të krijonim një tablo sa më të qartë të rezultateve apo mangësive si dhe problematikave të evidentuara.

Në këtë analize pune veç treguesve të përgjithshëm të ndjekjes penale, ngritjes së akuzes, përfaqësimit të saj, të mbikeqyrjes së ekzekutimeve të vendimeve penale, treguesve të punës së bërë nga secili prokuror dhe opgj-re, do të analizojmë në vecanti mangësit dhe shqetësimet në treguesit si më poshtë;

1. Drejtimit, shtrirja dhe tendencat (rritja ose zvogelimi) e përhapjes së veprave penale në përgjithësi dhe grup veprave të vecanta.
2. Si është zbatuar politika e procedimit dhe kërkesat për denime ndaj veprave të renda dhe sensitive.

3. Evidentimin e prioriteteve kryesore të punes ku do të synohet për vitin në vazhdim, drejtimet ku do të permiresohet puna në të ardhmen në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat.

I. Treguesit e kallëzimeve, akteve të referuara, dhe çështjeve Penale të trajtuara gjatë vitit 2016.

Konkretisht :

Për vitin 2016 në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat janë regjistruar 307

kallëzime dhe referime, nga keto :

- Nga nepunes publik 17
- Nga shtetasit 45
- Me ngjarje 97
- Kallëzime nga Policia Shtetit... 123
- Kallëzime te filluara kryesisht 3
- Ankime nga shtetasit 22

Në vemendjen e punes tonë, ka qenë evidentimi dhe studimi i materialeve të ardhura, verifikimi paraprake i tyre, rregjistrimi në kohe i procedimeve penale si dhe ndjekja në vijueshmeri e hetimit, për t'i perfunduar ato brenda afateve ligjore, në marrjen e vendimeve të arsyetuara, të bazuara dhe venjen në dijeni paleve e të interesuareve në kohen e duhur për t'u dhene mundesine e ankimit ligjor. Për vitin 2016 është vendosur mosfillim procedimi penale për 168 kallëzime... Ne totalin e pergjithshëm, një numer të konsiderueshem, rreth 40 % zene kallëzimet e bera nga shtetas të demtuar sipas parashkimeve të nenit 90 dhe 275 të K.Penal, dhe kallëzimet që ndiqen sipas nenit 59 e 284 të K.Pr.Penale, të cilat vijne nepermjet Komisarariatit te Policise se Rrethit Mat. Kerkesat ligjore të parashikuara në nenin 59 e vijues të K.Pr.Penale « I demtuari akuzues » (ku perfshihen këto vepra penale) parashikon se i demtuari nga këto vepra penale duhet ti drejtohet vete me kerkese Gjykates. Ndonese nuk është unifikuar një praktike lidhur me menyren e të proceduarit, këtë vite 24 kallëzime janë derguar direkte për kompetence gjykimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, kjo bazuar dhe në Vendimet e Gjykates së Larte nr.490 dt.14.10.2009, nr.527 dt.21.10.2009, nr.616 dt.18.11.2009 e cila ka pranuar të drejtë kerkesen e Prokurorise dhe kalimin e akteve Gjykates për kompetence gjykimi të ceshtjeve penale të parashikuara në nenin 59 K.Pr.Penale. Po keshtu gjatë vitit 2016 si rezultat i punes sqaruese dhe bindese të të demtuarve, janë drejtuar direkt Gjykatës Rrethit Gjyqësor Mat sipas kerkesave ligjore të parashikuara në nenin 59 e vijues të K.Pr.Penale, 2 shtetas. Në gjykimin e gjithe ketyre çështjeve ka qenë i pranishem perfaqesuesi i akuzes.

Referime në lidhje me veprat penale të parashikuara në Memorandumin e Bashkëpunimit.

Për vitin 2016 nuk ka patur asnjë referim nga KLSH-ja, si dhe nuk ka patur asnjë referim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nga Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave ka patur katër raste të referuar, nga këto për një raste është vendosur mosfillimi i procedimit penale, për një rast transferim dhe dy raste janë pezulluar deri në ardhjen e ekzekutimit të letër porosisë, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe ILDKP nuk ka asnjë referim.

Në bazë të të dhënave statistikore, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat për vitin 2016 (duke përfshirë 43 procedimet e mbartura nga viti 2015, si dhe rifillimet e procedimeve penale për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale) nga këto janë 107 procedime penale të rifilluar të pezulluar dhe pushuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, 43 procedime penale të mbartura nga viti 2015, si dhe 211 procedime penale të vitit 2016 (regjistrim si dhe të ardhur për kompetencë) të hetuar 354 procedime gjithsej me **59** persona nen hetim, **109** të pandehur, nga keta **90** arrest në burgë.

Nga totali i procedimeve penale të hetuara gjatë vitit 2016 kanë përfunduar gjithsej **349** (përfshirë këtu 107 rifillimet të pushuara për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale) ndërsa **242** procedime penale kanë përfunduar me **52** persona nen hetim, **109** të pandehur, **84** arrest në burgë . Menyra e përfundimit është si më poshtë:

- Derguara në gjyqe **101** ceshtje penale me **109** të pandehur, **63** me masë sigurimi arresti në burgë.
- Pushuara **180** (përfshirë **107** procedime për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale) si dhe **73** procedime penale të pushuara, me **48** persona nen hetim, nga keto **20** persona me masë sigurimi, pushuar për shkaqe të tjera, (*per incidentet në miniera pas administrimit të akteve, për vrasje nga pakujdesia pas administrimit te aktit mjeko ligjor që rezultoi me infkat të viktimës, për shkelje te rregullave pas administrimit të aktit autoteknik si dhe për proc.penale të regjistruar për nenin 88 K.Penal pas administrimit të aktit mjeko ligjor kanë rezultuar dëmtime sipas nenit 89 K.Penal*).
- Pezulluara **62** procedime.
- Transferuara **6** procedime penale me **4** person nen hetim, **1** arrest ne burg.
- Mbeten në hetim **8** procedime penale, me **7** persona nen hetim, **6** persona me masë sigurimi «arrest në burge».

Sipas prokurorëve për vitin 2016:

| Nr | PROKURORI | Gjiths | Gjyq | Pushuar | Pezull | Transf | Hetim |
|----|---------------------|--|---|---------|--------|--------|-------|
| 1 | Abaz Muça | 45 | 20 + 35 çesh.veç.penale 55 ceshtje perfaq.gjykim | 9 | 18 | 1 | ----- |
| 2 | Alketa Nushi | 65 +5 me zvend.prok 70 ceshtje | 22 | 27 | 16 | 1 | 4 |
| 3 | Alma Bramo | 66 + 6 me zevend.prok 72 ceshtje | 30 | 15 | 20 | 3 | 4 |
| 4 | Ajola Prenci | 19 | 10 | 5 | 4 | --- | ---- |
| 5 | Leonard Filopati | 1 | | 1 | | | |
| 6 | Besa Nikehasani | 2 | ----- | 2 | ---- | ----- | --- |

Çeshtjet e mbartura nga viti 2015 dhe menyra e perfundimit në vitin 2016.

| Nr | PROKURORI | Gjiths | Gjyq | Pushuar | Pezull | Transf |
|----|---------------------|--------|------|---------|--------|--------|
| 1 | Alketa Nushi | 24 | 13 | 7 | 4 | ----- |
| 2 | Alma Bramo | 7 | 3 | 2 | 1 | 1 |
| 3 | Ajola Prenci | 1 | ---- | 1 | ----- | --- |
| | Leonard Filopati | 10 | 7 | 2 | 1 | ----- |

Sipas mosfillimeve të procedimeve penale dhe rifillimeve.

| Prokurori | Mosfillim | Rifilluar | Pushuar/parashkr |
|--------------|-----------|-----------|------------------|
| Abaz Muça | 19 | 18 | 18 |
| Alketa Nushi | 56 | 24 | 24 |
| Alma Bramo | 55 | 23 | 23 |
| Ajola Prenci | 23 | 20 | 20 |

| | | | |
|-------------------------|-----------|--------------|-------------|
| Besa Nikehasani | 12 | 22 | 22 |
| Leonard Filopati | 5 | ----- | ---- |

Prokuroria Alma Bramo per periudhen raportuese veç sa siper, ka mbuluar detyren e Prokurorit te ekzekutimeve te vendimeve gjyqesore penale.

Prokurori Abaz Muça per periudhen raportuese veç sa siper, ka perfaqesuar organin e akuzes ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Mat ne gjykimin e kerkesave te te denuarve ne Burgun e Burrelit per lirim me kusht sipas nenit 64 e 59 K.Penal.

Sipas oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit.

| Nr. | Of.Pol.Gjy. | Gjiths | Gjyq | Pushuar | Pezulluar | Transf | Hetim |
|----------|-----------------|--------|------|---------|-----------|--------|-------|
| 1 | Artan Ballabani | 44 | 20 | 15 | 7 | ----- | 2 |
| 2 | Isak Hoxha | 36 | 9 | 18 | 7 | 1 | 1 |

Of.Pol.Gjyqesore Artan Ballabani ka mbajtur praktiken e ekzekutimeve të vendimeve penale si dhe njoftimeve e akteve në ekzekutim të letërporosive.

Për të krijuar nje ide sa më të qartë në lidhje me ngarkesën e punës paraqesim të dhenat sipas viteve, 2014, 2015 dhe 2016.

| VITI | Ceshtje të rregjistruara | Derguar në gjyqe | Pushuar | Pezulluar | Transferuar | Në hetim | Mosfillim |
|------|---------------------------------------|------------------|--------------------|-----------|-------------|----------|-----------|
| 2014 | 327 + 29 të mbartuar | 148 | 88 | 80 | 7 | 24 | 141 |
| 2015 | 306 + 24 të mbartura | 128 | 70 | 84 | 5 | 43 | 149 |
| 2016 | 211 + 43 të mbartura + 107 rifilluara | 101 | 73 + 107 rifilluar | 62 | 6 | 8 | 168 |

Referuar shifrave të lartepërmendura rezulton se dy vitet e fundit ka një rritje të ceshtjeve penale të rregjistruara si pasoje dhe tendence e rritjes së kriminalitetit konkretisht :

Tendence rritje kanë veprat penale të « Kultivimit të bimeve narkotike » sipas nenit 284 K.Penal. Për vitin 2016 janë rregjistruar 18 procedime penale, me këtë menyre perfundimi : 14 procedime penale janë pezulluar, 1 procedim penale me 3 persona nen hetim është në hetim, 1 procedim penal me një person arrest në

burg është transferuar për kompetencë lëndore Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tirane.

Për vitin 2015 janë mbartur 5 procedime penale, me këtë menyre perfundimi : 2 procedime penale janë pezulluar, 3 procedime penale me 4 të pandehur arrest në burg janë derguar në gjyqe dhe janë në process gjykimi.

Lidhur me veprat penale të « *Kultivimit të bimeve narkotike* » konstatojmë se :

1. Ndonese është bërë një fenomen shqetesues në komunitet dhe në fshatrat e rrethit Mat, hetimi për identifikimin e autoreve dhe ndeshkimin ligjore tyre lene shumë për të dëshiruar.
2. Ndonese në vendngjarje merren gjurme, sende mbi të cilat autoret kanë lene shenja etj, nga aktet e ekspertimit rezulton se ato nuk kanë vlera identifikuese gjë e cila tregon se nuk i është kushtuar sa duhet kqyrjes së kujdeseshme të vendit të ngjarjes.
3. Nuk ka një kombinim të punes mes strukturave të policisë për zbulimin e autoreve (për shkak edhe vete organizimit të srukturave brenda saj), nuk ka analizë konkrete për personat e dyshuar dhe për kontigjent të policisë që kanë aktivitet kriminal brenda dhe jashtë rrethit.
4. Deri tani puna e policisë gjyqësore është mjaftuar vetem në kryerjen e veprimeve të deleguara nga prokurori, administrimin e akteve dhe sygjerimin për pezullim të tyre.
5. Mungon strategjia në hetimin e ketyre ceshtjeve gjë e cila të ben të domosdoshme në të ardhmen, nderhyrjen e prokurorit që në fazen e keqyrjes së vendit të ngjarjes dhe marrjes së provave duke i perkushtuar një vemendje ma te madhe ketyre se deri tani kesaj vepre penale mjaft të perhapur dhe shqetesues për opinionin qytetare.
6. Veç dobesive të konstatuara në punen e policisë gjyqësore nuk duhet të harrojme edhe pergjegjesine që ka prokurori në hetimin e gjithëanshem të ceshtjes.

Tendence rritje kanë veprat penale «Dhuna në familje» parashikuar nga neni 130/a K.Penal. Për vitin 2016 janë rregjistruar 10 procedime penale, me këtë menyre perfundimi : 10 procedime penale derguar për gjykim me 10 persona të pandehur, nga këto 9 pandehur me masë sigurimi arrest në burg, (të perfunduara me fajesi sipas kerkeses së perfaqesuesit të akuzes).

Referuar gjendjes aktuale të dhunës në familje keto shifra nuk tregojnë realitetin për shkak se referuar kushteve ligjore kemi 16 raste të tjera që janë trajtuar me urdhër mbrojtje të lëshuar nga Gjykata, vlerësohet bashkepunimi i policisë në verifikimin dhe në mbikqyrjen e këtyre rasteve.

Tendence rritje kanë vepra penale të « *Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor* » sipas nenit 290/1/2/3 K.Penal. Duke cilesuar se gjatë vitit 2016 janë rregjistruar 10 procedime me 7 pandehur, 7 të pandehur arrest në burg, 6 derguar në gjyqe me 6 të pandehur me 3 të pandehur arrest në burg, 3

procedime penale të pushuar me 3 persona nen hetim dhe 1 proc.penale në hetim..

Referuar gjendjes aktuale, qarkullimit në rruge, sigurise publike nga qarkullimi i mjeteve, këto shifra nuk tregojnë realitetin për shkak se referuar kushteve ligjore të nenit 290 K.Penal, 10 materiale kallezuese me vendngjarje janë mosfilluar pasi shkeljet e drejtuesit të mjetit kanë qene pasoja, plagosje të lehtë apo demtime tjera sipas nenit 90 K.Penal, si dhe për shkaqe të tjera. Në të gjitha rastet e mosfillimit për këto vepra penale (për shkak të pasojës së ardhur), Sektori i Policisë së Qarkullimit Rrugor Mat është sygjëruar nga Prokurori për marrjen e masave administrative që parashikohen në «Kodin Rrugor». Duhet theksuar se siguria në rruge dhe vecanarisht në qytet nga qarkullimi i mjeteve lene shumë për të dëshiruar kjo ka ardhur edhe si pasojë e numerit të reduktuar të policisë rrugore.

Ndërsa për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i K.Penal janë 14 procedime penale me këtë mënyrë përfundimi, 14 procedime penale me 14 të pandehur me 12 të pandehur arrest në burg janë dërguar për gjykim. Nga këto 5 procedime penale me 5 të pandehur janë dërguar me gjykim të drejtëpërdrejtë.

Ka tendence ulje po perseri problem mbeten veprat penale të «Mbajtjes pa leje arme zjarri dhe municioni luftarak të parashikuar nga neni 278/1,2,3,4,5 K.Penal e shoqëruar dhe me vepra tjera si kanosje, prishje rendit dhe qetesise publike etj. Për vitin 2016 janë rregjistruar **8** procedime penale, me këtë menyre përfundimi : **6** procedime penale janë pezulluar, **2** procedime me **2** te pandehur arrest në burg janë dërguar në gjyqe dhe kanë përfunduar në fajësi sipas kërkesës së perfaqësuesit të akuzës.

Fakti që gjenden arme zjarri në vende publike, mbahen pa leje nga persona të ndryshëm edhe të mitur është një tregues që paraqet rrezikshmeri potenciale për jeten, rendin dhe qetesinë publike. Duhet theksuar se nga ana e forcave të policisë së komisarariatit rrethit Mat në lidhje me informacionin e marrë kanë treguar kujdes në vlerësimin e tyre në identifikimin e autoreve të mbajtjes së armeve pa leje etj.

Tendence ulje kanë veprat penale të «Vjedhjes së energjisë elektrike», parashikuar nga neni 137/1/2 K.Penal. Për vitin 2016 janë rregjistruar **5** procedime penale, me këtë menyre përfundimi : 5 procedime penale dërguar për gjykim me 5 persona të pandehur, nga këto 3 pandehur me masë sigurimi arrest në burg (të përfunduara me fajësi sipas kërkesës së perfaqësuesit të akuzës).

Një tendence ulje kanë veprat penale të «vjedhjes» parashikuar nga neni 134/1/2 etj K.Penal dhe po të bëjme krahasime në vite kjo veper penale ka ardhur duke u ulur, për vitin 2016 ka një ulje nga 60 procedime penale në vitin 2015 në 37 procedime penale në vitin 2016. Ndonese kjo veper penale ka tendence ulje forca zbuluese dhe goditese është mjaftë e vogël, këtë fakt e tregon numeri i dërgimit të ketyre ceshtjeve në gjyqe, nga 37 procedime penale, 4 procedime penale me 4 të pandehur, me 3 të pandehur me masë sigurimi arrest

në burg kanë perfunduar në gjyqe (të gjykuar me fajesi), 30 procedime penale janë pezulluar dhe 1 procedim penale është pushuar dhe 2 procedime penale janë transferuar. Në asnjë rast prokurori i seances në konkluzionet perfunditare, në kerkesat e tij për denimin e të pandehurve nuk ka rene nen minimum e kerkuar nga ligji.

Analizë e masave të sigurimit personal :

Gjatë vitit 2016 policia gjyqesore ka kryer **61** arrestime në flagrance, **3** ndalime, dhe janë kerkuar për **7** persona masë sigurimi arrest në burg në mungesë. Është kerkuar vleftesimi i **64** arrestimeve në flagrance dhe ndalimeve të kryera nga pol.gjyqesore dhe prokurori. Në të gjitha rastet e kerkesave të prokurorit për caktimin e mases së sigurimit është mbajtur parasyshe rrethanat e kryerjes së vepres penale, rrezikshmeria shoqerore të saj, autorit dhe shkalles së perhapjes së veprave penale në rrethin e Matit.

Në menyre të permbledhur po paraqesim kerkesat e prokurorit dhe vendimet e gjykates për cakimin e mases së sigurimit.

| KERKESA E PROKURORIT | | VENDIMI I GJYKATES | |
|-----------------------------|----|-----------------------------|----|
| Masa sig. a.burge + ab mung | 49 | Mase sig. a.burge + ab mung | 39 |
| A.shtepi | 5 | A.shtepi | 7 |
| A.burg me afat | 11 | A.burg me afat | 11 |
| Garanci pasurore | 2 | Garanci pasurore | 4 |
| Detyr. paraqitje | 4 | Detyr. Paraqitje | 10 |

Siç shikohet në shumicen e rasteve të kerkuara nga ana e jone për caktimin e mases së sigurimit të arrestit në burge jemi perkrahur nga gjykata. Në katër rastë është ushtruar ankim nga Prokurori kundër vendimit të Gjykatës në Gjykatën e Apelit Tiranë, dhe një rast nga mbrojtësi. Në një rast është prishur vendimi i gjykatës nga masa e sigurimit me afat në masë sigurimi pa afat.

Afatet e hetimit :

Për vitin raportues afatet e hetimit paraqiten si më poshtë. Deri në tre muaj ka perfunduar hetimi për 216 (përfshirë dhe procedimet penale të mbartuar nga viti 2015) procedime penale me 135 të pandehur, nga keto 72 arrest në burg. Nga 3 muaj – 6 muaj ka perfunduar hetimi për 18 procedime penale me 12 të pandehur nga keto 6 me masë sigurimi, dhe mbi 6 - 9 muaj ka perfunduar hetimi për 12 procedime penale me 20 të pandehur me 1 arrest në burg, dhe mbi 9 muaj - 1 vit ka përfunduar hetimi për 4 ceshtje me një të pandehur.

Pra, siç del dhe nga këto të dhena statistikore hetimi është bere brenda afateve ligjore dhe çdo zgjatje e dhene ka qenë e argumentuar. Duhet theksuar se *verehet tendece e opgj-re që çeshtja të mbahet në dore edhe pa veprime deri në afatet perfundimtare ndonese urdheri për kryerjen e veprimeve të prokurorit percakton qartë afatin e perfundimit tyre*. Po, kjo nuk anashkalon pergjegjesine e Prokurorit të ceshtjes në ndjekjen në vijueshmneri dhe dinamike të hetimit, pjesmarrjes në hetim dhe jo duke u mjaftuar vetem me urdherimin e kryerjes së veprimeve hetimore e caktimin e një afati dhe në pritje të perfundimit tij.

Për ceshtjet e GJYKUARA :

Në gjykim :

Mbartë në gjykim nga viti 2015: **34** ceshtje penale me **48** të pandehur, **25** me arrest në burg.

Gjithesej në gjykim për vitin 2016: **135 ceshtje penale, me 157** të pandehur me **88** arrest në burg, nga keto **11** të pandehur me masë sigurimi me afat, (janë për nenin 85 dhe 290).

Të gjykuara :Gjithesej **119** (përfshirë 2 ceshtje sipas nenit 90 KP) ceshtje penale me **137** të pandehur nga keta **75** a.burge.

Mbeten në gjykim nga viti 2016: **16** ceshtje penale me **20** të pandehur, **13** me arrest në burg.

- *Me gjykim të zakonshem* **44** ceshtje me **53** të pandehur;
- *Me gjykim të shkurtuar* **65** ceshtje me **74** të pandehur
- *Me gjykim në mungesë* **4** ceshtje me **4** të pandehur
- *Me gjykim të drejteperdrejte* **8** ceshtje me **8** të pandehur

Kerkesat e prokurorit në gjykim dhe vendimet e gjykates në perfundim të gjykimit për vitin 2016, paraqiten si më poshtë :

| KERKESA E PROKURORIT | VENDIMI I GJYKATES |
|----------------------------|---------------------------|
| Gjobe - 23 | Gjobe - 18 |
| Burge 113 | Burge - 108 |
| | |
| Terheqje aktesh - 1 | Kthim akt- 1 |
| Pushim ceshtje - 1 | Pushim ceshtje – 4 |
| Pushim akuze ----- | Pushim akuze - ---- |
| Pafajesi----- | Pafajesi - 7 |
| Burgim perjetshem ----- | Burgim perjetshem ----- |

Sipas vendimeve gjyqësore rezulton se 108 të pandehur janë denuar me burgim dhe 18 me gjobe. Nga keta, 12 me paraburgim, 30 burgim mesatar, 35 në minimumin e parashikuar nga ligji dhe 3 sipas nenit 53 të K.Penale ; 28 të pandehurve të denuar me burgim ju është pezulluar ekzekutimi i vendimit me burgim sipas nenit 59 K.Penal dhe 3 të pandehur jane denuar sipas nenit 53 të K.Penal.

Sipas kerkesave të Prokurorit, rezulton se është kërkuar për 113 të pandehur burgim dhe për 23 të pandehur gjobe. Nga keta, për asnjë të pandehur nuk është kërkuar me paraburgim, për 68 të pandehur është kërkuar burgim mesatar, për 23 të pandehur është kërkuar minimumi i parashikuar nga ligji dhe për asnjë të pandehur nuk është kërkuar neni 53 i K.Penale, për 22 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim sipas nenit 59 të K.Penal.

Kerkesa e Prokurorit për masën e denimit vazhdimisht ka qenë në perputhje me dispoziten ligjore të parashikuar në K.Penal, shkallen e perhapjes dhe të rrezikshmerise shoqerore të autorit dhe veprës penale si dhe zbatim të urdherit të Prokurorit te Pergjithshem për politiken e denimit të veprave penale sensitive me rrezikshmeri shoqerore. Megjithate,duhet pranuar se ashpersia e politikës penale të denimit nuk ka qenë në lartesine e duhur gjë e cila është pergjegjesi direkte e stafit të prokurorëve dhe drejtuesit të saj. Në punën në vazhdim, më të ashper duhet treguar në hetimin dhe në kerkesen perfundimtare për veprat penale të kultivimit të bimëve narkotike si një veper kjo mjaft e perhapur në shkalle rrethi dhe Republike, si dhe për veprat penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor dhe të mbajtjes pa leje të armëve në mjedise publike.

Analize e pafajesive, kthim aktesh dhe ndryshim akuze, pushim ceshtje:

Pafajesi dhe kthim aktesh për vitin 2016, ka patur 7 pafajesi, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat. Këto pafajesi i ka marrë Prok.A.Bramo (3 pafajesi) dhe Prok.A.Nushi (4 pafajesi).

Për veprën penale të parashikuar nga neni 277 K.Penal, përfaqësuar në hetim dhe në gjykim nga Prok.A.Bramo dhe është në process gjykimi në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 242 K.Penal, përfaqësuar në hetim dhe në gjykim nga Prok.A.Bramo dhe është në process gjykimi në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 248 K.Penal, përfaqësuar në hetim nga Prok.A.Prençi dhe në gjykim nga Prok.A.Bramo dhe është në process gjykimi në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 186 K.Penal, përfaqësuar në hetim nga Prok.L.Filopati dhe në gjykim nga Prok.A.Bramo dhe është në process gjykimi në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 135 K.Penal, përfaqësuar në hetim dhe në gjykim nga Prok.A.Nushi dhe është në process gjykimi në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 284/1 K.Penal, përfaqësuar në hetim dhe në gjykim nga Prok.A.Nushi dhe është në process gjykimi në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 306 K.Penal, përfaqësuar në hetim dhe në gjykim nga Prok.A.Nushi dhe është në process gjykimi në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 186/3 K.Penal, përfaqësuar në hetim dhe në gjykim nga Prok.A.Nushi dhe është në process gjykimi në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Ndersa terheqje aktesh ka pasur vetem në një rast nga prok.A.Nushi, dhe Gjykata ka vendosur vetem për një rast kthim aktesh i cili bën fjale për veprën penale të parashikuar nga neni 135 të K.Penal dhe është derguar perseri për gjykim dhe është në process gjykimi..

Pushim akuze dhe ceshtje : Gjykata gjatë vitit 2016 ka dhene 1 vendim pushim akuze dhe 2 vendime pushim ceshtje penale.

PËR CESHTJET E PUSHUARA NË HETIMET PARAPRAKE:

Për periudhen raportuese rezulton se nga totali i procedimeve të rregjistruara janë pushuar **73** procedime penale me **48** persona nen hetim, me **20** persona me masë sigurimi nga këta 2 persona me arrest në burgë. Konkretisht procedimet penale të pushara janë.

| | | | |
|--|---------|---|------------|
| Për veprën penale të parashikuar nga neni 84 K.P | pushuar | 5 | procedime. |
| Për veprën penale të parashikuar nga neni 85 K.P | pushuar | 1 | procedime. |
| Për veprën penale të parashikuar nga neni 89 K.P | pushuar | 7 | procedime. |
| Për veprën penale të parashikuar nga neni 99 K.P | pushuar | 1 | procedime. |
| Për veprën penale të parashikuar nga neni 124/1 K.P | pushuar | 1 | procedime. |
| Për veprën penale të parashikuar nga neni 126 K.P | pushuar | 1 | procedime. |
| Për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a/1K.P | pushuar | 1 | procedime. |
| Për veprën penale të parashikuar nga neni 134/1 K.P | pushuar | 2 | procedime. |
| Për veprën penale të parashikuar nga neni 137/2 K.P | pushuar | 1 | procedime. |
| Për veprën penale të parashikuar nga neni 143/1K.P | pushuar | 2 | procedime. |
| Për veprën penale të parashikuar nga neni 145 K.P | pushuar | 3 | procedime. |
| Për veprën penale të parashikuar nga neni 151 K.P | pushuar | 1 | procedime. |
| Për veprën penale të parashikuar nga neni 186/1 K.P | pushuar | 4 | procedime. |

Për vepren penale të parashikuar nga neni 187/1 K.P pushuar 2 procedime.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 199/a/1K.P pushuar 2 procedime.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 200 K.P pushuar 1 procedime.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 205 K.P pushuar 4 procedime.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 237 K.P pushuar 1 procedime.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 248 K.P pushuar 8 procedime.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 255 K.P pushuar 1 procedime.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 259 K.P pushuar 1 procedime.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 275 K.P pushuar 13 procedime.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 287/1 K.P pushuar 1 procedime.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 289/1 K.P pushuar 3 procedime.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 290/1 K.P pushuar 1 procedime.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 290/2 K.P pushuar 1 procedime.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 290/3 K.P pushuar 1 procedime.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 306 K.P pushuar 1 procedime.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 309 K.P pushuar 1 procedime.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 324/a/1 KP pushuar 1 procedime.

PËR CESHTJET E PEZULLUARA NË HETIMET PARAPRAKE.

Pasi janë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore, gjatë vitit 2016 janë pezulluar për mos zbulim autori **62** procedime penale.

Çeshtjet e pezulluara sipas veprave penale paraqiten si më poshtë ;

Për vepren penale të parashikuar nga neni 134/1 K.P pezull. 30 proc. penale.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 143 K.P pezull. 1 proc.penale.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 151 K.P pezull. 2 proc. penale.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 186/1 K.P pezull. 1 proc.penale.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 237K.P pezull. 1 proc.penale.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 274 K.P pezull. 1 proc.penale.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 278/2 K.P pezull. 1 proc.penale.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 278/4 K.P pezull. 4 proc. penale.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 275 K.P pezull.dhe rif.dhe dërguar gjy 1 proc. penale.

Për vepren penale të parashikuar nga neni 284/1 K.P pezull. 17 proc. penale.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 287/1 K.P pezull. 2 proc.penale.
Për vepren penale të parashikuar nga neni 290/1 K.P pezull. 1 proc.penale.

Sa sipër rezulton, se numrin më të madh të ketyre çështjeve e zene vepra penale e vjedhjes me **30** procedime penale si dhe e kultivimit të bimeve narkotike me **17** procedime penale.

Siç del nga këto të dhëna rezulton se puna zbuluese dhe investiguese në zbulim të autorit/ve është shumë e dobte. Mendoje se kjo fillon që në momentet e kqyrjes së vendit të ngjarjes dhe veprimet pasuese ku mjaftohet vetëm me një proces verbale keqyrje dhe nuk hetohet me kujdes në marrjen e gjurmëve apo ndertimin e punës operative në zbulim të autorit/ve të kultivimit të bimëve narkotike.

Për çështjet e transferuara ;

Për vitin 2016 janë transferuar sipas kompetences gjithësejt **6** procedime penale me **4** persona nën hetim dhe me **1** person me arrest në burje .

Çështjet e rifilluara;

Janë rifilluar 107 çështje penale të ardhura nga Komisariati i Policisë Mat, me qëllimin pushimin e tyre për shkak të parashkrimit, dhe janë pushuar 107 procedime penale për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

Apelimet në Gjykatën e Apelit

Nga Çështjet penale të gjykuara dhe të perfunduara në Gjykatën e Rrethit e Gjyqësor Mat, janë 119 çështje penale, si dhe 35 çështje janë të veçanta penale dhe 71 janë masa sigurimi të dhëna nga gjykata. Në 36- raste është ushtruar ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë. Nga këto, 31 për çështje penale, 5 për masa sigurimi, 4 janë apele kundërshtuese, 6 ankime për lirim me kusht.

GJYKIME ME OBJEKT LIRIM ME KUSHT

Është perballuar një ngarkesë e konsiderueshme e gjykimeve penale me objekt kërkesat për lirim me kusht sipas nenit 64 dhe qendrimi në shtëpi sipas nenit 59/a të K.Penal, kjo për shkak perfshirjes të I.E.D.Penale Burrel në juridiksionin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

Konkretisht është marrë pjesë në 35 -çështje të veçanta penale me objekt “lirim me kusht” dhe dënim alternativ, pra gjithsej 35 gjykime.

Nga 35 - gjykime me objekt kerkesa për lirim me kusht dhe dënime alternativ, ka përfunduar gjykimi për 34 gjykime dhe një mbartet në gjykim.

Në 16- raste janë pushuar, në 5 raste janë rrezuar kërkesat e të denuarve me këtë objekt, ndërsa në 6 raste është vendosur pranimi i kerkeses dhe liruar me kusht.

Është ushtruar ankim për 7- raste (një nga i dënuari) kunder vendimit të gjykates për lirim me kusht sipas nenit 64 dhe 59/a të K.Penal dhe janë në proces gjykimi në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Në Gjykimet me objekt lirim me kusht duhen evidentuar disa mangesi e konkretisht. M.gj.s janë gjykime administrative është krijuar nje ngarkese relativisht e madhe, seancat shtyhen disa here, përgjithësisht për mungese dokumentacioni të paraqitur bashkangjitur kerkeses nga të denuarit që vuajne dënimin. Përgjithësisht çdo gjykim realizohet me 4-a me shumë seanca Gjyqësore.

Ekzekutimet për vitin 2016:

Gjatë vitit 2016 nga ana e **Zyres së Ekzekutimeve** në Prokurorinë e Rrethit Mat, janë leshuar :

1.Urdhera ekzekutimi gjithesej 189, konkretisht ;

- 3 urdhera ekzekutimi burgim të përjetshëm,
- 28 urdhera ekzekutimi për vendime denimi me burgim,
- 28 urdhera ekzekutimi për vendime denimi me gjobe,

Për denime alternative gjithesej 48 urdhera ekzekutimi.

- Neni 59, i K.Penal ----- 37
- Neni 59/a i K.Penal..... 2
- Neni 64 i K.Penal 6
- Neni 63 i K.Penal 2
- Neni 53/a i K.Penal 1

Urdhura të tjerë ekzekutimi.

- 59 urdhera ekzekutimi për shpenzime proceduriale,
- 17 urdhera ekzekutimi për prova materiale,
- 1 urdher ekzekutimi për amnisti,
- 1 urdher ekzekutimi për bashkim denimesh,
- 4 urdhera ekzekutimi për zgjatje afati mbikqyrje tek shërbimi i provës,

2.Vendime të ekzekutuara gjithesej janë 11 me burgim, 3 me gjobë, 77 për nenin 59 K.Penal, 2 për nenin 59/a K.Penal, 7 për nenin 64 K.Penal, dhe 10 për nenin 63 K.Penal.

3. Vendime të pa ekzekutuara gjithesej 3 me burgim të përjetshëm, 28 denime me burgim dhe 17 denime me gjobe si dhe 17 janë në shërbim prove dhe 59 urdhera ekzekutim për shpenzime procedurale të pa ekzekutuara.

Kompensim burgimi padrejte. Gjatë vitit 2016 ka patur 3 kërkesa për kompensim burgimi të padrejtë.

Zevendesime prokurori në hetim dhe gjykim si dhe opgj-re në hetim. Në 20 raste janë zevendesuar prokuroret për shkak të transferimit të Prokurores A. Prençi në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe kalimit Prokurorit L.Filopati në detyrën e inspektimit pranë Ministrisë së Drejtësisë. Është treguar një kujdes i vecante që të kemi sa me pak zevendesime të prokurorit si në hetim dhe gjykim apo të opgj-re në hetim. Në cdo rast zevendesimet janë bërë për shkaqe të bazuara. Zevendesime të opgj-re janë bërë për shkak të trasferimeve të opgj-re. Duhet thënë se kemi patur edhe raste tjera të zevendesimit të prokurorit për arsye të ngutshme me qellim që seanca gjyqësore të mos shtyhet.

USHTRIMI I ROLIT DHE KOMPETENCAVE TË DREJTUESIT TË PROKURORISË

Në veprimtarinë e ndjekjes penale për çështjet e hetuara dhe të perfaqesuara në gjykim, një rol luan dhe ushtrimi i kontrollit nga Drejtuesit e Prokurorisë, të Prokurorit të Rrethit, në lidhje me studimin dhe vendimarrjen për regjistrimin e çështjeve penale, kontrollin në dinamike, menyres së përfundimit të çështjeve, si dhe krijimit të marrëdhënieve me Prokurorët dhe Of/Pol/Gjyqësore, të seksionit të Prokurorisë dhe seksioneve dhe shërbimeve të Policisë, si dhe me Institucionet e tjera .

Gjatë periudhës që analizojmë nga Drejtuesit e Prokurorisë është ushtruar studimi i të gjitha materialeve kallëzuese dhe të referuara nga Policia Gjyqësore si ato me vendngjarje, duke marrë vendimet përkatëse për regjistrimin e çështjeve.

Në të gjitha rastet është bërë përpjekje për një respektim të një proporcionaliteti në shpërndarjen e ngarkesës për Prokuror dhe Of/Pol/Gjyqësore kjo e evidentuar dhe në statistiken e lartpërmendur.

Urdhërat dhe udhëzimet e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, janë punuar dhe diskutuar për implementimin e tyre. Një kujdes është bërë për respektimin dhe zbatimin e urdherit të përbashkët të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrisë së Brendshme, për funksionimin e Shërbimeve të Pol/Gjyqësore në Policinë e Shtetit. Në lidhje me këtë urdher disa here janë kryer takime dhe në Drejtorinë e Policisë Qarkut Diber, si dhe për çdo rast të evidentimit të shkeljeve u është dërguar shkresë përkatëse.

Është ushtruar kontroll në dinamike të çështjeve penale gjatë hetimeve paraprake, janë evidentuar dhe kërkuar verbalisht veprime konkrete që duhet të kryhen.

Në të gjitha rastet e zgjatjeve të afatit të hetimeve kerkesave për vleftësim dhe caktim masë sigurimi, si dhe konkluzioneve përfundimtare është zbatuar me korrektesi Urdheri i Prokurorit të Përgjithshëm në lidhje me kontrollin dhe ciklimin e tyre akteve dhe administrimin të një kopje në fashikullin perkates.

Janë organizuar dhe kryer analiza për çështje të veçanta të here pas-hershme, të protokolluara, ku është urdheruar me shkrim kryerja e veprimeve hetimore plotesuese, si dhe në shumë raste urdhera për riformulimin e akteve apo vendimeve përfundimtare.

MARRËDHENIET ME INSTITUCIONET

Marrëdhënie institucionale me Institucionet e tjera kanë qenë ligjore dhe korrekte, dhe në veçanti me Drejtorinë e Policisë së Qarkut Diber, Komisaritetet përkatëse Mat dhe Diber, si dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat dhe Prokurorinë e Apelit Tiranë.

Marrëdhëniet që burojnë për shkak të veprimtarisë dhe procedurave ligjore, të hetimit dhe perfaqesimit në gjyq, pra me Policinë dhe Gjykatën, janë krijuar marrëdhënie bashkepunimi si në aspektin organizativ ashtu dhe atë ligjor në respektim të kryerjes së detyrave në afate nga seksionet e Pol/Gjyqësore dhe shërbimet, ashtu dhe respektimin dhe korrektesinë në zhvillimin e seancave Gjyqësore me Gjykatën.

Nuk janë evidentuar raste të shtyrjes së seancave Gjyqësore për mosparaqitjen e Prokurorëve, dhe nga ana e Gjykatës duhet vlerësuar fakti i perballimit të një ngarkese të madhe.

Në lidhje me materiale kallezuese jo të plota, kur janë evidentuar mangësi etj, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë janë dërguar me shkrim verejtjet për problematiken e konstatuar në materiale kallëzuese dhe çështje penale të veçanta, ku është konfirmuar nga ana e Policisë trajtimi i problematikave të ngritura në funksion të permiresimit të punes.

Nje problematike e evidentuar në raport me Policinë, pra shërbimet e Pol.Gjyqësore, janë levizjet e shpeshta të oficerëve. Ka shumë raste të zevendesimit në një procedim Penal të –Of/Pol/Gjyqësore. Kjo për shkak të levizjeve të shpeshta nga një sektor në tjetrin, ka raste që dosjet janë sjelle në Prokurori pas 1-muaji nga levizjet, pa relacion etj. Rezultojnë dhjete -raste të zevendesimit të Of/Pol/Gjyqësore.

Ajo që duhet evidentuar si mangësi është mos trajtimi i rasteve të shkeljeve duke kaluar në procedim disiplinor Of/pol/Gjyqësore. Gjatë dinamikës së punes në hetimin e çështjeve shpesh evidentojmë të meta dhe mangësi, shkelje ligjore, që janë trajtuar duke tërhequr vemendjen apo kanë mbetur thjesht ankime verbale. Për këto raste nga drejtuesi i prokurorisë u është kërkuar Prokurorëve që të

informojne me shkrim për rastet e konstatuara dhe jo të mbetemi thjesht në ankesa të perditeshme, duke i trajtuar me fryme liberale dhe jo ligjore. Kjo është një mangesi dhe për Drejtuesin në rastet e konstatimit të këtij fakti.

Gjithashtu duhen evidentuar marrëdhëniet me Zyren e Prokurorit të Përgjithshëm, në funksion të zbatimit të urdherave dhe udhezimeve të ardhura. Evidentojmë se nga nxjerrja e tyre kanë gjetur zbatim dhe ndikuar në mbarevajtjen e veprimtarisë së Prokurorisë në hetimin e çështjeve dhe perfaqesimin në gjykim. Vleresojme analizat e bëra për disa çështje të veçanta pranë Drejtorise se Kontrollit dhe Hetimit, në lidhje me vleresimin dhe interpretimin ligjor të problematikave të krijuara.

Gjithashtu ka patur një bashkepunim për tu evidentuar me Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me ekzekutimin e leter-porosive me autoritetet e huaja. Në të gjitha rastet janë kryer veprimet procedurale brenda afateve, kjo dhe për bashkepunimin dhe ruajtjen e kontaktit në dinamike për të gjitha rastet.

Të dhëna lidhur me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja:

Ekstradime - një person është ekstraduar për jashtë.

Letërporositë - një kërkesë për letër porosi për kryerje veprimesh hetimore, Njohjet e vendimeve penale - tre kërkesa për njohje vendimesh penale të huaja dhe më pas ekstradimi i tre personave nga jashtë për të vuajtur dënimin në Republikën e Shqipërisë.

Transferimet e personave të dënuar - një person është transferuar për jashtë, si dhe transferim procedimesh penale nuk ka pasur.

Shpallje kërkimi ndërkombëtar – për 11 persona dhe heqje nga kërkimi ndërkombëtar për 4 persona.

Duhet evidentuar fakti i një bashkepunimi korrekt dhe me vlerë me zyrën e S.P.M.T.Sh.I në Prokurorinë e Përgjithshme.

INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISË

Në mbarevajtjen e punës të veprimtarisë së Prokurorisë një rol të rëndësishëm kryen dhe administrata e Prokurorisë.

Rezulton tashme një evidencë e saktë dhe e qartë që nga momenti i protokollimit të materialeve në k/sekretari, e më pas në regjistrat e regjistrimit të çështjeve dhe të mosfillimeve mbajtur nga sekretari dhe Kryesekretarja, dhe në zbatimin të sistemit « CAMS » si dhe krijimi i një Arshive me regjister korrekt për hyrjet dhe tërheqjet e dosjeve, vetëm me autorizim dhe shenime përkatëse.

Nga ana e zyrës së finances janë evidentuar me korrektesi shpenzimet procedurale të çështjeve Penale, të cilat për vitin 2016 rezultojnë në vlerën 1.807.100 leke. Nga këto shpenzime për ekspertime 1.919.800 leke, për avokate në vlerën 34.000 leke, për mosfillime 399.900 leke, për procedime penale 1.807.100 leke. Gjithashtu nga kjo zyre është mbajtur evidence e saktë në lidhje

me pagesat e gatishmerise dhe oreve jashtë orarit zyrtar që rezulton në vlerën 352288 leke.

Në kuader të zbatimit të V.K.M nr.591 date 23.07.2010 “Për disiplinimin e perdorimit të fondeve buxhetore” nga ana jonë po behen përpjekje për një menaxhim sa më të kujdesshem të ketyre fondeve.

Ndërsa marrëdhëniet me median dhe publikun kanë qenë korrekte, në lidhje me median është njoftuar zyra përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme në lidhje me rastet.

DREJTIMET DHE PRIORITETET E PUNES PËR VITIN 2017

Sa u referuan treguesit e sipërpërmendur, në analizë të tyre, duhet të evidentojmë dhe drejtimit kryesore të punes dhe veprimtarisë për vitin në vazhdim 2017, duke percaktuar dhe prioritetet kryesore.

Nga drejtimet duhen vlerësuar :

Së pari, një nder drejtimit kryesore të veprimtarisë së punes për vitin 2017, duhen evidentuar ***ngritja e cilesise*** së hetimeve, pra e cilësisë së veprimeve hetimore të procedimeve Penale.

Cilesia në veprime pasqyron së pari ngritjen profesionale të çdo Prokurori dhe Of/Pol/Gjyqësore, duke e pasqyruar atë në perpilimin e akteve, formulimit dhe arsytimit ligjor të vendimeve gjatë hetimit, ato përfundimtare si dhe perfaqesimit në Gjykatë.

Së dyti, duhet rritur ndjeshëm ***kontrolli në dinamike*** nga ana e prokuroreve gjatë hetimeve paraprake të çështjeve, duke mos u mjaftuar vetëm me nxjerrjen e një urdheri për kryerje veprimesh hetimore, pritjen deri në ardhjen e akteve nga shërbimet e Pol.Gjyqësore, duke shkaktuar vonesa në hetim, humbjen e aktualitetit të një veprimi hetimore që mund të rezultojë gjatë dinamikës etj. Në dinamike gjatë kontrollit të veprimtarisë hetimore nga Of/pol/Gjyqësore Prokurori duhet të jetë jo vetëm një orientues i veprimeve hetimore apo të nxjerrë akte procedurale për veprime specifike si kontrole pergjime etj, por duhet të jetë dhe inicues apo nxites për një hetim sa më dinamik, të shpejtë, të një hetimi të zgjeruar për të gjitha problematikat. Duhet të evidentojë konkretisht dhe percjelle me informacione drejtuesit të prokurorisë apo në Prokurori të Përgjithshme problematika të veçanta, pengesa të ndryshme qofte që kanë të bëjnë dhe me mënyrën e funksionimit të organizimit të punes së veprimtarisë hetimore, siç janë zvarritjet etj.

Së treti, për çështje të veçanta për shkak të rrezikshmerisë shoqerore apo përhapjes së një krimi duke ju referuar tendencës pra të kriminalitetit, aq më teper për çështje të rënda dhe sensitive duhet bërë ***vleresimi i diferencuar***, kryer analiza të vleresimit të hetimeve dhe provave të administruara, duke lene detyra

konkrete, si dhe duke kryer vetë nga Prokurorët veprime hetimore. Gjithashtu nga evidentimi i një mangesie të vitit 2016 në lidhje me kryerjen e veprimeve hetimore nga vetë Prokurorët, këtë vit duhet vlerësuar me korrektesi sidomos zbatimi i neni 256 të K.Pr.Penale në lidhje me pyetjen e të arrestuarve, apo delegimi i përfundimit të hetimeve që jo rrallë u është deleguar Of/Pol/Gjyqësore. Marrja kontakt që në momentet e para nga prokurori me të dyshuarin (arrestuarin) krijon një perceptim më të drejtë në lidhje me hetimet që do kryhen më pas, shmang dhe probleme procedurale në lidhje me zgjedhjen e masës shtrënguese të marrë nga shërbimet e Pol/Gjyqësore, si dhe për krijimin e një politike të drejtë të kërkeses për masë sigurimi, bazuar dhe në personalitetin e të dyshuarit etj.

Në prioritetet për vitin në vazhdim 2017

Së pari, evidentimi, vleresimi dhe hetimi i veprave Penale të referuara apo të evidentuara kryesisht, që lidhen me veprime korruptive, të cilat kanë të bëjnë me subjekte të administrates shtetërore. Duhet nenvizuar fakti që nga ana e prokurorëve duhet treguar vemendje më e madhe në drejtim të vleresimit të fakteve që rezultojnë gjatë hetimeve, për raste kur konstatohen indicie për vepra Penale të karakterit korruptiv. Duhet treguar vemendje dhe në drejtim të fakteve për të cilat ndjehet shqetesim i përgjithshëm i komunitetit.

Së dyti, kryerja e analizave të perbashketa me seksionet dhe sektoret e shërbimeve të Policisë për veprat penale sensitive, ku duhet përmendur kultivimin e bimëve narkotike, si një nga prioritetet dhe të vitit të kaluar për parandalim por që nuk rezultojnë rezultate në identifikimin e autoreve për këtë vepër penale gjatë vitit 2016.

Së treti, Rifillimi i çështjeve të pezulluara sipas nenit 326 të K.Pr.Penale, për veprat penale të renda siç janë vrasjet e pazbuluara, të cilat rezultojnë në një numër të konsiderueshem të pezulluara dhe asnjë rast referimi për rifillim hetimesh.

| KRIME KUNDËR JETËS ME DASHJE | 2015 | | | | | 2016 | | | | |
|--|-----------------|----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|-----------------|----------------------|--------------------------------|----------------------|-----------------|
| | Nr. Procd. Regj | Nr. procd per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Procd. Regj | Nr. procd per gjykim | Nr. i pand. Regj. ¹ | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 76 Vrasja | | | | | | | | | | |
| Neni 77 Vrasja për një krim tjetër | | | | | | | | | | |
| Neni 78 Vrasja me paramendim | | | | | | | | | | 2 |
| Neni 78/a Vrasje per gjakmarrje | | | | | | | | | | |
| Neni 79 Vrasja në rrethana cilësuese | 2 | 1 | 2 | 1 | 1 | | | | | |
| Neni 79/a Vrasja e funksionarëve publikë | | | | | | | | | | |

¹ Ky tregues është totali i personave në hetim dhe të pandehur të regjistruar në organin e prokurorisë.

² Nuk janë përfshirë vrasjet e mbetura në tentativë (65 procedime regjistruar dhe 60 pandehur regjistruar).

Neni 79/b Vrasja e
punonjësve të Policisë së

Shtetit

| | | | | | | | | | | |
|---|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|
| Neni 79/c Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare | | | | | | | | | | |
| Neni 80 | | | | | | | | | | |
| Neni 81 Vrasja e foshnjës | | | | | | | | | | |
| Neni 82 Vrasja në tronditje psikike | | | | | | | | | | |
| Neni 83 Në kapërcim mbrojtjes nevojshme | | | | | | | | | | |
| Neni 83/a Kanosje për hakmarrje/ gjakmarrje | | | | | | | | | | |
| Neni 83/b Nxitja për gjakmarrje | | | | | | | | | | |
| Neni 84 Kanosja | 6 | 1 | 2 | 1 | 3 | 7 | 1 | 6 | 1 | 1 |
| Totali | 8 | 2 | 4 | 2 | 4 | 7 | 1 | 6 | 1 | 1 |

| KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI | 2015 | | | | | 2016 | | | | |
|---|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|-----------------|----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|
| | Nr. Procd Regj | Nr. procd per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Procd. Regj | Nr. procd per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 85 Vrasja nga pakujdesia | | | | | | 1 | 0 | 2 | 0 | 0 |
| Totali | | | | | | 8 | 1 | 8 | 1 | 1 |

| VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE | 2015 | | | | | 2016 | | | | |
|--|----------------|----------------------|-------------------|----------------------|------------------|----------------|----------------------|------------------|---------------------|------------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. Proc. për gjykim | Nr. i Pand. Regj. | Nr. Pand. Për gjykim | Nr. Pand dënua r | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. për gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand dënu ar |
| Neni 86 Tortura | | | | | | | | | | |
| Neni 87 Tortura me pasoja të rënda | | | | | | | | | | |
